

Zekirja SHABANI
Instituti Albanologjik
Prishtinë

STRUKTURA EKONOMIKE E LAGJES GAZI ALI BEJ NË KASABANË E VUSHTRRISË NË MESIN E SHEK. XIX

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Analiza e strukturës ekonomike e Lagjes Gazi Ali Bej të Kasabasë së Vushtrrisë ofron një vështrim të detajuar mbi strukturën e profesioneve dhe burimeve të të ardhurave gjatë mesit të shekullit XIX, duke zbuluar diversitetin ekonomik dhe ndikimin në jetën e komunitetit. Duke u bazuar në Temettuat Defterin e vitit 1845, të regjistruar në Arkivin Osman me numër fondi ML.VRD.TMT.d.15477, si dhe në burime të tjera historike, ky studim kategorizon burimet kryesore të të ardhurave që kontribuuan në zhvillimin ekonomik të lagjes, përfshirë artizanatet, tregtignë, qiratë dhe të ardhurat nga organet e sigurisë etj. Një fokus i veçantë është vënë në të ardhurat nga shfrytëzimi i tokave bujqësore dhe livadheve, duke theksuar rëndësinë e ekonomisë agrare për jetën e përditshme dhe mirëqenien e popullsisë lokale. Studimi analizon rolin e profesioneve dhe burimeve të ndryshme të të ardhurave, duke nxjerrë në pah rëndësinë e ekonomisë së diversifikuar për ruajtjen e stabilitetit social-ekonomik të popullsisë në lagjen Gazi Ali Bej.

Fjalët kyçe: *Kasabaja e Vushtrrisë, struktura ekonomike, tregtia, artizanatet, qiradhënia etj.*

Hyrje

Elementet bazë ekonomike në Perandorinë Osmane, përfshirë kasabanë e Vushtrrisë, mund të klasifikohen në disa sektorë kyçë, që kontribuonin në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror: menaxhimi i tokës dhe politikat bujqësore. Ky sektor përfshinte shpërndarjen dhe përdorimin e tokave bujqësore si dhe mbikëqyrjen e prodhimit bujqësor. Tokat administroheshin përmes një sistemi kompleks të pronësisë dhe qiradhënies, ndërsa politikat e prodhimit dhe tregtimit përfshinin zhvillimin e zejtarive dhe industrisë lokale, si dhe marrëdhëniet tregtare që lidheshin me rajonet përreth. Politikat monetare dhe fiskale përpiloheshin rreth problemit të mbledhjes efikase të taksave dhe administrimit të burimeve financiare.¹ Madje, me reformat e Tanzimatit përpjekjet për të vendosur parime të reja në Perandorinë Osmane u theksuan ndjeshëm, duke reflektuar një transformim të rëndësishëm në themelet e strukturës ekonomike dhe shoqërore të saj. Këto reforma pasqyronin vendimin e Perandorisë për t'u perëndimozuar dhe modernizuar në të gjitha institucionet e saj.² Ekonomia e kasabasë së Vushtrrisë në mesin e shekullit XIX karakterizohej nga një ndërthurje e ngushtë mes veprimtarive prodhuese dhe atyre konsumuese, që ishin thelbësore për jetën e përditshme të banorëve. Këto veprimtari përfaqësonin ngjarje ekonomike të rëndësishme dhe ndikonin drejtpërdrejt në zhvillimin shoqëror të zonës. Marrëdhëniet ndërmjet mirëqenies së banorëve dhe fuqisë ekonomike të kasabasë ishin të ndërlidhura, duke përfshirë burimet natyrore, prodhimin bujqësor dhe zejtarinë si bazë të ekonomisë lokale.³ Përcaktimi i strukturës ekonomike të lagjes Gazi Ali Bej të kasabasë së Vushtrrisë⁴ është bërë

¹ Mustafa Cüneyt Uzun, "Osmanlı Ekonomisinin temel unsurların Ekonomik yaklaşımlar çerçevesinde değerlendirilmesi", *Karşıya Sosyal Araştırmalar Dergisi*, Nr. 3, 2019, 56. (54-93)

² Halil Inalcık, "Tanzimat Nedir". *Tanzimat*. Ed. Halil Inalcık ve Mehmet Seyitdanlıoğlu, İstanbul: Türkiye İş Bankası Yayınları, 2011, 32 (31-56); Abdüllatif Şener, "Tanzimat ve Meşrutiyette İktisadi ve Mali Politikalar", *Osmanlı Ansiklopedisi*, Vellimi 3, 1999, 549.(548-562)

³ Ali Özgüven, *İktisat Bilimi'ne Giriş*, İstanbul, 1991, 3.

⁴ Vushtrria në burimet osmane përmendet me emrin Vulçitrin. Gjatë periudhës së hershme të administrimit osman në këtë rajon, Vushtrria u bë një nga qendrat më

duke analizuar Defterin e Temettuat-it⁵ të kazasë së Vushtrrisë, i cili është regjistruar me numrin 15477 në katalogun e Defterëve Temettuat, të Ministrisë së Financave në Arkivin Osman të Presidencës. Ky dokument ofron të dhëna të detajuara mbi strukturën dhe gjendjen ekonomike të banorëve, përfshirë të ardhurat dhe aktivitetet e tyre prodhuese e tregtare, duke mundësuar një pasqyrë të qartë mbi strukturën shoqërore dhe ekonomike të rajonit gjatë periudhës osmane. Temettuat defteri i vitit 1261 H. përbëhet nga 331 faqe, që përfshijnë kasabanë dhe fshatrat e Vushtrrisë. Megjithatë, ky studim do të fokusohet te lagjja Gazi Ali Bej, në kasabanë e Vushtrrisë, të dhënat për të cilën fillojnë në faqen 2 dhe vazhdojnë deri në faqen 20. Kjo lagje përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme socio-ekonomike të kasabasë dhe ofron një pamje të detajuar të strukturës së saj shoqërore dhe ekonomike gjatë periudhës osmane.⁶

të rëndësishme politike dhe ekonomike të Perandorisë Osmane në Ballkan. Pas pushtimit osman të Kosovës, u krijua njësi territoriale dhe administrative e njohur si "Vilajeti i Vellk," e cila më vonë u shndërrua në Sanxhakun e Vushtrrisë gjatë sundimit të Sulltan Mehmetit II, duke u bërë një nga sanxhakët kryesorë të administratës osmane. *Vendbanimet e Kosovës*, Vëllimi I, Qendrat Urbane, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018, 287; *Kosova në vështrim enciklopedik*, Tiranë, Toena, 1999, 28; Muhammet Aruçi, "Vulçitrin", *Islam Ansiklopedisi*, Vëllimi 43, 2013, 132; Muhamet Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1995, 21; Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV. XVI dhe XVII*, Rilindja Prishtinë, 1982, 51.

⁵ Fjala "temettu" është një fjalë me origjinë arabe, e cila rrjedh nga fjala "temettû" dhe nënkupton fitime ose përfitime. Mehmet Zeki Pakalin, *Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü*, Vëllimi I-II, İstanbul, Milli Eğitim Bakanlığı Yayını, 1983, 453.

⁶ Arkivi Osman i Kryeministrisë (BOA). Ministria e Financave (ML).VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-73) (Başbakanlık Osmanlı Maliye Nezareti, Varidat Muhasebesi, Temettuat Kalemi Defterleri); Popullsia e këtyre lagjeve në kasabanë e Vushtrrisë gjatë mesit të shekullit XIX karakterizohej nga një diversitet etnik dhe fetar. Zekirja Shabani, "Analizë e defterit të Xhizjes në Vushtrri H.1258 (1842)", *Gjurmime Albanologjike* 52, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2022, 146; Hyrrem Çavush ishte një nga lagjet më të vjetra të Vushtrrisë, e cila përmendet që nga shekulli XVI. Ismail Arslan, "19. Yüzyıl Ortalarında Balkanlarda Bir Osmanlı Kasabasının Sosyo-Ekonomik Yapısı: Vulçitrin", *Türk Dünyası İncelemeleri Dergisi*, Vëllimi 12, 2012, 414.

Struktura e profesioneve në kasabanë e Vushtrrisë

Struktura sociale e banorëve sipas profesioneve në kasabanë e Vushtrrisë gjatë mesit të shekullit XIX luante një rol të rëndësishëm ekonomik dhe shoqëror, duke kontribuar në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të larmishme. Kombinimi i profesioneve, si: tregtarë, bujq, zejtarë dhe funksionarë administrativë, siguronte zhvillim të qëndrueshëm dhe ekuilibër ekonomik për komunitetin. Ky diversitet jo vetëm që nxiste zhvillimin e tregtisë dhe bënte sigurimin e shërbimeve jetike për banorët, por gjithashtu krijonte stabilitet social-ekonomik, duke e shndërruar kasabanë e Vushtrrisë në një qendër aktive dhe të rëndësishme në rajon. Në mesin e shekullit XIX lagja Gazi Ali Bej⁷, në kasabanë e Vushtrrisë, karakterizohej nga një larmi profesionesh të ushtruara nga banorët. Nga të dhënat e regjistrimeve 17 profesione të ndryshme ushtroheshin nga kryefamiljarët e kësaj lagjeje, duke pasqyruar një mozaik të gjallë aktiviteteve ekonomike. Prej tyre, rreth 29.42% e kryefamiljarëve ushtronin dy profesione, duke siguruar kështu të ardhura nga më shumë se një burim. Kjo lloj shumanësie profesionale pasqyronte fleksibilitetin e banorëve të kohës, të cilët përballeshin me ndryshimet ekonomike dhe sociale në mënyrë të adaptueshme. Gjithashtu, 17.64% e tyre ishin në moshë të shtyrë ose në pension, duke lënë profesionet që dikur kishin ushtruar, por që gjithsesi kontribuan në trashëgiminë e tyre profesionale në shoqëri. Ndër profesionet më të zakonshme, tregtarët përbënin një përqindje të konsiderueshme prej 19.11%, duke u bërë një shtyllë kyçe e jetës ekonomike në lagje. Bujqit, me një përqindje prej 17.64%, përfaqësonin një pjesë të madhe të popullsisë, duke ndihmuar në furnizimin e tregut lokal dhe në mbështetjen e jetës rurale që lidhte qytetin me zonat përreth. Shërbimet e ndryshme ishin gjithashtu të

⁷ Në lagjen Gazi Ali Bej të kasabasë së Vushtrrisë jetonin 83 familje, të cilat përbënin popullatën myslimane. Disa nga anëtarët kryesorë të këtyre familjeve përfshijnë: Ibrahimin, djalin e Haxhi Mustafas; Yusufin, djalin e Haxhi Mehmetit; Ismail Aga, djalin e Hysen Agës; Haxhi Bahtijarin, djalin e Sylejmanit; Mehmeti, djalin e Molla Murselit; dhe shumë të tjerë si Mustafa, Tahiri, Ramizi, dhe Hasan, të cilët ishin të lidhur ngushtë me emrat e prindërve të tyre. Këto emra pasqyrojnë strukturën familjare dhe lidhjet shoqërore brenda komunitetit mysliman të lagjës. Zekirja Shabani, “Blegjoria në Kasabanë e Vushtrrisë”, 179-180.

pranishme, me shërbyesit që përbënin 7.35% të kryefamiljarëve, duke siguruar ndihmë dhe lehtësi në shtëpitë e familjeve më të pasura ose të tregtarëve. Në mesin e profesioneve të tjera që gjenin vend në këtë komunitet të larmishëm përfshiheshin ndihmësrrabaqepësit dhe njësitë në xhandarmëri, të cilët përfaqësonin 5.88% të banorëve dhe ndihmonin në mbajtjen e rregullit publik dhe në përmbushjen e nevojave të përditshme të banorëve. Gjithashtu, disa kryefamiljarë ushtronin profesione si: pronar i fermave, tregtar i sendeve të vjetra dhe nallban, që ishin mjaft të rëndësishme për komunitetin. Në këtë shoqëri të pranishëm ishin edhe rrobaqepësit, ndihmësberberët dhe kalorësit timarli, duke sjellë një shumëllojshmëri të roleve në strukturën e jetës së përditshme. Lagjja Gazi Ali Bej kishte gjithashtu esnafë, duke përfshirë profesionin e kafexhinjve. U dalluan profesioni i karrocierit, i kopshtarit, i imamit. Një tjetër profesion unik ishte ai i çaparxhinjve, të cilët merreshin me gërmime dhe hapjen e tokës, duke siguruar përgatitjen për bujqësinë ose ndërtime të reja. Në fund, disa banorë kishin role në administratë, duke kontribuar në funksionimin e përgjithshëm të qytetit dhe duke mbajtur strukturën organizative të komunitetit.⁸

Strukturat ekonomike në lagjen Gazi Ali Bej

Të ardhurat nga tregtia në mesin e shekullit XIX në lagjen Gazi Ali Bej, të kasabasë së Vushtrrisë, ishin një komponent thelbësor i ekonomisë lokale, duke kontribuar ndjeshëm në mirëqenien e banorëve të saj. Këto të ardhura përfshinin kryesisht ato që vinin nga dyqanet që merreshin me shitjen e produkteve ushqimore, frutave dhe produkteve të tjera të përditshme. Dyqanet ishin pika të rëndësishme të tregtisë lokale. Përveç produkteve ushqimore, tregtia e drunjve dhe e lëndëve të tjera ndihmonte në mbulimin e nevojave të tjera si dhe për prodhimin e objekteve të ndryshme artizanale. Aktivitetet tregtare në këtë lagje reflektuan një vitrinë të diversitetit ekonomik dhe një mundësi për banorët që të angazhoheshin në tregti si një formë jetese. Këto aktivitete tregtare gjeneronin një shumë të

⁸ Arkivi Osman i Kryeministrisë (BOA). Ministria e Financave (ML).VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-73) (Başbakanlık Osmanlı Maliye Nezareti, Varidat Muhasebesi, Temettuât Kalemi Defterleri)

konsiderueshme që arrinte në 5,550.5 kurushë. Kjo shifër simbolizonte vitalitetin e tregtisë në lagje dhe ndikimin e saj të rëndësishëm në mirëqenien ekonomike të banorëve. Nga ana tjetër, të ardhurat nga artizanatet në lagjen Gazi Ali Bej përfshinin zanate të ndryshme, si: përpunimi i drurit, kasapllëku, kafexhinia dhe rrobaqepësia. Këto aktivitete artizanale ishin thelbësore për zhvillimin ekonomik të lagjes, duke ofruar jo vetëm produkte të nevojshme për jetesën e përditshme, por edhe shërbime që ndihmonin në ruajtjen e traditave kulturore dhe artizanale të komunitetit. Përpunimi i drurit, për shembull, ishte një zanat i rëndësishëm që përfshinte krijimin e objekteve të ndryshme. Kasapllëku ishte një tjetër zanat i rëndësishëm, që mundësonte produkte të freskëta dhe të cilësisë së lartë për banorët. Kafexhinia, nga ana tjetër, ofronte një vend takimi për banorët, ku ata mund të shijonin kafe dhe të socializoheshin. Këto aktivitete kontribuuan jo vetëm në ekonominë lokale, por gjithashtu ndihmonin në forcimin e lidhjeve shoqërore dhe kulturore midis banorëve. Rrobaqepësia ishte gjithashtu një zanat i rëndësishëm në lagje, duke ofruar veshje të personalizuar dhe të përshtatura për nevojat e klientëve. Këto aktivitete artizanale gjeneronin rreth 9,991 kurushë të ardhurash, gjë që tregon se artizanët luanin një rol të rëndësishëm në furnizimin e komunitetit me produkte dhe shërbime të nevojshme. Kjo shumë përfaqësonte një kontribut të konsiderueshëm në ekonominë e lagjes, duke e bërë atë një nga bazat kryesore të zhvillimit të saj ekonomik. Të ardhurat nga kalorësit timarë ishin gjithashtu një burim i rëndësishëm i të ardhurave për lagjen Gazi Ali Bej. Kalorësit që kishin një timar, një formë pronësie ose shpërblimi në sistemin osman, përfitonin nga burimet e tokës dhe aktivitetet bujqësore që ndihmonin në mbështetje të jetesës së tyre. Këta pronarë tokash gjeneronin një total prej 2,224.5 kurushë të ardhurash. Timarët luanin një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në lagje. Kjo kontribuonte në rritjen e potencialit ekonomik të lagjes dhe ndihmonte në ruajtjen e stabilitetit social. Një nga zërat ekonomikë me më shumë të ardhura në lagjen Gazi Ali Bej të kasabasë së Vushtrrisë ishin të ardhurat nga çifligu, prona, qiraja e çifligut, dhe aktiviteti bujqësor.⁹ Në mesin e shekullit XIX këto aktivitete kishin

⁹ BOA. ML.VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-20)

një ndikim të rëndësishëm në ekonominë lokale, duke gjeneruar një shumë të konsiderueshme të ardhurash prej 20,666.5 kurushë. Kjo shifër tregon jo vetëm potencialin e fortë të çifligut, pronave, bujqësisë në këtë lagje, por gjithashtu rëndësinë e saj për mirëqenien e banorëve. Çifligjet ishin toka të mëdha të punuara që ofronin mundësi të shumta për prodhimin e kulturave të ndryshme. Qiraja e çifligut gjithashtu përbënte një burim të rëndësishëm të ardhurash për pronarët e tokës, të cilët shpesh e jepnin tokën me qira për fermerët që do të punonin. Kjo marrëveshje krijonte një lidhje të dobishme për të dy palët, ku pronarët përfitonin nga qiraja dhe fermerët kishin qasje në tokën që i nevojitej për të kultivuar kultura bujqësore. Kjo dinamikë ekonomike është reflektim i një sistemi bujqësor të qëndrueshëm, i cili ishte i integruar në strukturën sociale dhe ekonomike të lagjes. Kështu, të ardhurat nga çifligu dhe aktiviteti bujqësor në lagjen Gazi Ali Bej ishin thelbësore për zhvillimin ekonomik të saj, duke ofruar burime të qëndrueshme për mirëqenien e banorëve dhe duke kontribuar në krijimin e një strukture ekonomike të fortë dhe të diversifikuar. Të ardhurat që siguroheshin nga shërbimi në xhandarmeri ishin gjithashtu një pjesë e rëndësishme e ekonomisë lokale në lagjen Gazi Ali Bej, duke arritur një total prej 662.5 kurushë. Këto të ardhura ishin të lidhura ngushtë me funksionin e sigurisë publike që xhandarët ofronin, duke reflektuar një aspekt të rëndësishëm të organizimit shoqëror dhe administrativ të kohës. Të ardhurat momentale dhe të paparashikuara, të ardhurat nga kafshët, livadhet dhe burime të tjera ishin gjithashtu të rëndësishme për ekonominë e Gazi Ali Bej, duke përfshirë një total prej 1,854.5 kurushë. Kjo shumë e konsiderueshme tregon se lagja kishte një gamë të gjerë burimesh dhe aktiviteteve ekonomike, që së bashku kontribuan në zhvillimin e saj të qëndrueshëm dhe prosperitetin e banorëve. Për një pasqyrim më të qartë të strukturës së shpërndarjes së të ardhurave në lagjen Gazi Ali Bej, paraqitet grafiku vijues.¹⁰

¹⁰ BOA. ML.VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-20)




Tabela 1. Struktura e të ardhurave ekonomike në lagjen Gazi Ali Bej në Vushtrri në gjysmën e shek. XIX

Siç po shihet edhe nga grafiku i mësipërm, në lagjen Gazi Ali Bej të kasabasë së Vushtrrisë, gjatë shekullit XIX, struktura ekonomike ishte e larmishme dhe e diversifikuar, me të ardhurat totale që arrinin në 37,209.5 kurushë. Të ardhurat nga çifligu, bujqësia, qiratë shfaqen si burimet kryesore të të ardhurave, duke kontribuar me 55.54% të totalit të të ardhurave. Aktivitetet çifligare, pronësore dhe bujqësore ishin thelbësore për sigurinë ushqimore dhe stabilitetin ekonomik të lagjes, duke reflektuar rëndësinë e këtij sektori në mirëqenien e banorëve. Tregtia, që gjeneronte 14.92% të të ardhurave, tregonte vitalitetin e aktiviteteve tregtare dhe ndikimin e tyre në ekonominë lokale. Pronarët timarë kontribuan me 8.76% të të ardhurave në strukturën ekonomike të lagjes Gazi Ali Bej. Artizanatet, përkatësisht zanatet si përpunimi i drurit, kasapllëku dhe kafexhinia ofronin një kontribut të moderuar prej 8.04% të të ardhurave. Ndërsa puna e shërbëtorit dhe ajo me karrocë, që siguronte 5.98% të të ardhurave, ishte gjithashtu e rëndësishme brenda komunitetit në zërat e të ardhurave ekonomike. Të ardhurat nga xhandarmëria, me një kontribut prej 1.78%, ishin më të vogla, por ende të rëndësishme për sigurinë publike dhe ruajtjen e rendit. Të ardhurat momentale dhe të paparashikuara nga kafshët, livadhet dhe burime të tjera përbënin

4.98% të totalit, duke dëshmuar se lagja Gazi Ali Bej kishte një gamë të gjerë burimesh dhe aktiviteteve ekonomike. Analiza e të ardhurave në Gazi Ali Bej tregon një strukturë të diversifikuar ekonomike, e cila kontribuonte në një zhvillim të qëndrueshëm. Ky diversifikim ofronte një mbështetje të rëndësishme për lagjen. Rëndësia e çifligut, pronës, tregtisë, artizanateve dhe zërave të tjerë ekonomikë thekson nevojën për një qasje të integruar në analizën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, duke njohur se çdo sektor kontribuon në mënyrë të veçantë për prosperitetin e përgjithshëm të shoqërisë.¹¹

Në periudhën osmane, toka e kultivuar ishte një nga burimet e tjera të rëndësishme për gjenerimin e të ardhurave ekonomike dhe mirëqenien e komunitetit. Të ardhurat nga toka e kultivuar përbënin një pjesë të rëndësishme të buxhetit të familjeve dhe të shtetit, i cili përfitonte nga taksat mbi prodhimin bujqësor. Një tokë e kultivuar dhe e mirëmenaxhuar ndikonte drejtpërdrejt në zhvillimin e rajonit, pasi ajo kontribuonte jo vetëm në prodhimin ushqimor, por edhe në mbajtjen e tregjeve lokale aktive dhe të qëndrueshme. Në këtë kontekst, lagjja Gazi Ali Bej shfaqet si një shembull i qartë i rëndësisë së tokës së kultivuar për ekonominë lokale në mesin e shekullit XIX. Në këtë lagje, toka klasifikohet në tokë të kultivuar, të pakultivuar dhe në livadhe. Duke i analizuar këto kategori të tokës, në totalin e përgjithshëm të lagjes, shohim se 45.25% e tokës ishte e kultivuar, 3.04% ishte tokë e pakultivuar dhe pjesa më e madhe, prej 51.69%, përbëhej nga livadhe. Kjo ndarje e tokës në lagjen Gazi Ali Bej ilustron një balancim mes tokave për prodhim bujqësor dhe atyre për kullosa, duke siguruar një sistem të qëndrueshëm të gjenerimit të të ardhurave për popullsinë lokale. Tokat e kultivuara ishin thelbësore jo vetëm për mbijetesën, por edhe për rritjen ekonomike, ndërsa livadhet siguronin mjetet për mbajtjen e kafshëve, që ishin po ashtu të rëndësishme për ekonominë bujqësore të kohës.¹²

Nga tokat e kultivuara, banorët e lagjes Gazi Ali Bej të Kasabasë së Vushtrrisë, gjatë kësaj periudhe, gjeneronin të ardhura bruto prej 12,401 kurushë. Kjo shumë përfaqësonte një burim të rëndësishëm ekonomik për komunitetin lokal, i cili varej në masë të madhe nga bujqësia për mirëqenien e vet. Për të ardhurat e realizuara, banorët

¹¹ BOA. ML.VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-20)

¹² BOA. ML.VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-20)

paguanin një taksë prej 1,187.5 kurushë, duke e ulur shumën e të ardhurave të përgjithshme pas tatimit në 11,926 kurushë. Megjithatë, nga kjo shumë e përgjithshme bruto, një pjesë prej 475 kurushë nuk ishte subjekt i tatimit, gjë që mund të jetë reflektim i një rregulloreje fiskale ose lehtësimi për kategori të caktuara. Nga ana tjetër, tokat e pakultivuara nuk kishin potencial për të gjeneruar të ardhura të konsiderueshme. Vlera e të ardhurave ishte e papërfillshme, ndërsa edhe taksat e mbledhura për këtë kategori tokash ishin të ulëta. Për një shumë minimale prej 35 kurushë të ardhurash nga toka e pakultivuar, taksat arrinin vetëm në 3.5 kurushë. Ndërsa livadhet në lagjen Gazi Ali Bej luanin një rol të rëndësishëm në ekonominë e zonës duke siguruar të ardhura prej 2,340 kurushë. Livadhet, të cilat kryesisht shërbenin si kullosa për bagëtinë, përbënin një burim shtesë të të ardhurave, duke kontribuar në mirëqenien e komunitetit dhe e diversifikonin ekonominë lokale.¹³ Megjithëse sipërfaqja e livadheve ishte më e madhe se ajo e tokës së kultivuar në lagjen Gazi Ali Bej, kontributi i saj në të ardhurat e përgjithshme nga toka ishte i vogël. Livadhet siguronin vetëm 15.87% të të ardhurave totale të gjeneruara nga të gjitha kategoritë e tokës në këtë lagje. Kjo përqindje, ndonëse e konsiderueshme, tregonte se livadhet kishin një rol mbështetës ekonomik, kryesisht përmes kullosës së bagëtive, dhe jo një burim të drejtpërdrejtë të prodhimeve me vlerë të lartë tregtare. Në kontrast, toka e kultivuar përbënte shumicën dërrmuese të të ardhurave, duke gjeneruar 84.13% të të ardhurave totale nga tokat. Ky dallim midis kontributit të tokës së kultivuar dhe livadheve nënvizon një aspekt të rëndësishëm të strukturës ekonomike të lagjes Gazi Ali Bej. Ndërkohë që livadhet përmbushnin një nevojë të rëndësishme për kafshët dhe për mbajtjen e një sistemi të qëndrueshëm agro-bujqësor, toka e kultivuar mbetej shtylla kryesore ekonomike e banorëve. Ky lloj menaxhimi i diferencuar i burimeve tokësore i lejonte banorët që t'i diversifikonin të ardhurat dhe i mbështeste aktivitetet bujqësore dhe blegtorale, duke siguruar një strukturë ekonomike të qëndrueshme.¹⁴

¹³ Gjatë kësaj periudhe, në lagjen Gazi Ali Bej, blegtoria përbënte një nga sektorët kryesorë ekonomikë të bujqësisë, me një total prej 248 bagëtish të imta dhe të mëdha. Nga produktet e këtyre bagëtive, disa prej tyre gjeneronin të ardhura prej 1,720.5 kurushëve. Zekirja Shabani, "Blegtoria në Kasabanë e Vushtrrisë", 180.

¹⁴ BOA. ML.VRD.TMT.d.15477 (faqe 2-20)

Përfundim

Studimi i strukturës ekonomike dhe profesionale në lagjen Gazi Ali Bej të Kasabasë së Vushtrrisë gjatë mesit të shekullit XIX paraqet një model të larmishëm, ku secili sektor kontribuonte në stabilitetin dhe zhvillimin social-ekonomik të komunitetit. Ndërthurja e profesioneve të ndryshme, përfshirë tregtarët, bujqit, zejtarët dhe funksionarët administrativë, krijoi një bazë të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik të kasabasë, duke e kthyer lagjen Gazi Ali Bej në një qendër të rëndësishme për aktivitetet ekonomike dhe sociale. Sipas të dhënave historike, 17 zanate të ndryshme ushtrorëshin në këtë lagje, ku 29.42% të pjesëtarëve të kësaj shoqërie ushtronin më shumë se një profesion, duke siguruar qëndrueshmëri më të madhe ekonomike dhe fleksibilitet ndaj kushteve të ndryshme sociale dhe ekonomike. Burimet kryesore të të ardhurave vinin nga tregtia, artizanatet, çifligu, qirratë, dhe toka e kultivuar. Tregtia përqendrohej kryesisht në dyqane që ofronin produkte të përditshme, ndërsa artizanatet, përfshirë përpunimin e drurit, kasapllëkun dhe kafexhinë, luanin një rol të rëndësishëm në ruajtjen e traditave kulturore të komunitetit. Tokat e kultivuara dhe livadhet gjithashtu kishin ndikim të madh ekonomik; megjithëse livadhet zinin një sipërfaqe të gjerë, toka e kultivuar mbetej burimi kryesor i të ardhurave bujqësore. Struktura e larmishme e profesioneve dhe e burimeve të të ardhurave në lagjen Gazi Ali Bej tregon një ekonomi të ndërtuar mbi diversifikim dhe adaptim. Ekonomia lokale, e mbështetur nga profesione të shumta dhe burime të ndryshme, siguronte stabilitet dhe qëndrueshmëri, duke e pajisur komunitetin me aftësinë për t'u përballur me sfidat socio-ekonomike të mesit të shekullit XIX.

BIBLIOGRAFIA

Arkivi osman

T.C. Cumhurbaşkanlığı Devlet Arşivleri Başkanlığı, Maliye Nezareti, Varidat Muhasebesi, Temettuât Kalemi Defterleri) ML. VRD.TMT.d.15477.

Literatura

Arslan, İsmail. "19. Yüzyıl Ortalarında Balkanlarda Bir Osmanlı Kasabasının Sosyo-Ekonomik Yapısı: Vulçitrın", *Türk Dünyası İncelemeleri Dergisi*, Vëllimi 12, 2012.

Aruçi, Muhammet. "Vulçitrın", *İslam Ansiklopedisi*, Vëllimi 43, 2013.

Inalcık, Halil. "Tanzimat Nedir". *Tanzimat*. Ed. Halil Inalcık ve Mehmet Seyitdanlıoğlu, İstanbul: Türkiye İş Bankası Yayınları, 2011, 31-56.

Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë, Toena, 1999.

Özgülven, Ali. *İktisat Bilimi'ne Giriş*, İstanbul, 1991.

Pakalin, Mehmet Zeki. *Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü*, Vellimi I-II, İstanbul, Milli Eğitim Bakanlığı Yayını, 1983.

Rizaj, Skender. *Kosova gjatë shekujve XV. XVI dhe XVII*, Rilindja Prishtinë, 1982.

Shabani, Zekirja. "Analizë e defterit të Xhizjes në Vushtrri H.1258 (1842)", *Gjurmime Albanologjike* 52, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2022, 135-159.

Shabani, Zekirja. "Blegtorja në Kasabanë e Vushtrrisë në vitin 1261 H. (1845)", *Gjurmime Albanologjike* Nr. 53, 2023, 175-200.

Şener, Abdüllatif. "Tanzimat ve Meşrutiyette İktisadi ve Mali Politikalar", *Osmanlı Ansiklopedisi*, Vëllimi 3, 1999, 548-562.


Tërnavë, Muhamet. *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1995.

Uzun, Mustafa Cüneyt. "Osmanlı Ekonomisinin temel unsurların Ekonomik yaklaşımlar çerçevesinde değerlendirilmesi", *Karatya Sosyal Araştırmalar Dergisi*, Nr. 3, 2019, 54-93.

Vendbanimet e Kosovës, Vëllimi I, Qendrat Urbane, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018.

Shtojca

Faksimile: Faqet katër dhe pesë të Temettuat Defterit të lagjes Gazi Ali Bej, të Kasabasë së Vushtrrisë.



ML.VRD.TMT.d.15477

THE ECONOMIC STRUCTURE OF THE GAZI ALI BEY NEIGHBORHOOD IN THE TOWN OF VUSHTRRI IN THE MID- 19TH CENTURY

Summary

The economic structure of the Gazi Ali Bey neighborhood in 1845 presents a diverse array of professions and income sources that had a profound impact on the life and stability of the community. Drawing from the Temettuat Defter of 1845 (ML.VRD.TMT.d.15477) and various historical sources, the study categorizes primary income streams—including crafts, trade, rentals, and security services—as key contributors to economic growth in the neighborhood. A particular emphasis is placed on the revenues generated from agricultural lands and pastures, underscoring the essential role of agrarian economics in sustaining the daily life and well-being of the local population. This rich economic diversity across sectors helped maintain socio-economic stability, allowing the Gazi Ali Bey neighborhood to remain resilient and adaptable amid the shifting conditions of mid-19th century Vushtrri.